



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIMIT  
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "KOLE MARGJINI" SHKODER

Nr. 196 Prot.

Shkoder më 31.10.2022

Lënda : Njoftim për levizje paralele

Drejtuar: AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIMIT,  
Tiranë

Ne zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr. 15/2017 datë 16/02/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", Neni 19 të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional", Urdhrit nr.172, datë 24.12.2019 "Për miratimin e strukture dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive" profesional'si dhe Udhëzimin nr.28, datë 14.10.2019. "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit profesional "

Ju njoftojmë për dy vend të lira në pozicionin e mesimdhënës në teorinë profesionale, drejtimi mësimor dega pyje ( Inxhinjer Pyjesh ) Shkolla Teknike Pyjore "KOLE MARGJINI" SHKODER

Mesimdhënie të kulturës profesionale në ofruesit të AFP-se duhet të përmbushë këto kritere:

1. Kriteret e përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

2..Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorise profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim profesional:

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barazvlefshëm në të njëjtën fushë, që lidhet me kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-se;
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet,
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

#### Dokumentat e aplikimit

Dosja e aplikimit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë duhet të përfshijë:

- Letermotivim për pozicionin
  - Jetëshkrimin (CV)
  - Karte identiteti
  - Diplomen
  - Librezën e punës
  - Cdo dokumentacion që verteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV
  - Certifikat ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit.
  - Vertetim i gjendjes shëndetësore
  - Vertetimin e gjendjes gjyqësore
  - Vertetim nga punëdhënësi i fundit ,që ndaj ti nuk janë marr mas disiplinore të cilat sjane në fuqi
  - te paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
- Te gjitha dokumentat të jenë origjinale ose të noterizuara, dokumentat në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe noterizuara,
- Dokumentat e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP –se deri më datë 08.11 2022

Drejtori

Albana Lleshaj

